



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT



Save the Children

# SHKOLLA

## Qendër Komunitare

### MODULE TRAJNIMI



**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

# **SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE**

**MODULE TRAJNIMI**

**Tiranë, 2015**

*Ky botim publikohet në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtës së fëmijëve për edukim dhe zhvillim tërësor” të organizatës Save the Children, të zbatuar në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.*

*Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të arsimit për zhvillim politikash dhe praktikash arsimore, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e të dy institucioneve si burim. Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.*

**MODUL TRAJNIMI**

**PLANIFIKIMI NË SHKOLLËN QENDËR  
KOMUNITARE**

**Tiranë, mars 2015**

## Tabela e përmbajtjes

- <b>Hyrje</b> .....	5
- <b>Seanca I.</b> Lloji i planifikimit dhe indikatorët e planifikimit .....	7
- <b>Seanca II.</b> Karakteristikat e mjedisit, konteksti ku ndodhet shkolla.....	9
- <b>Seanca III.</b> Mënyrat e menaxhimit për rritjen e efektivitetit dhe të cilësisë në shkollë .....	11
- <b>Shtojca I.</b> Programi i trajnimit.....	13
- <b>Shtojca II.</b> Formulari i vlerësimit .....	14

## Hyrje

<b>Tema kryesore e trajnimit</b>	Aftësitë e facilitimit gjatë planifikimit në shkollë
<b>Nëntemat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lloji i planifikimit dhe indikatorët e planifikimit</li> <li>- Karakteristikat e mjedisit, konteksti ku ndodhet shkolla</li> <li>- Mënyrat e menaxhimit për rritjen e efektivitetit dhe cilësisë në shkollë</li> </ul>
<b>Objektivi i përgjithshëm</b>	Aftësimi i pjesëmarrësve për të organizuar planifikimin e suksesshëm në shkollën qendër komunitare
<b>Nënobjektivat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njohim elementet e organizimit të planit me bazë shkollë dhe klase.</li> <li>- Të njohim hapat e menaxhimit të suksesshëm në shkollën qendër komunitare</li> </ul>
<b>Grupi i synuar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësues</li> <li>- Drejtues</li> </ul>
<b>Kohëzgjatja</b>	Trajnimi është programuar të zgjasë nga ora 9.00 deri në 13.00.
<b>Metodologjia</b>	<p>Trajnimi do të fokusohet kryesisht në punën me grupe. Kjo mënyrë organizimi mundëson jo vetëm pjesëmarrjen aktive të pjesëmarrësve, por lejon hapësirën e nevojshme që ata të ndajnë me njëri-tjetrin përvojën e deritanishme me trajnimet, një element ky tejet i rëndësishëm për temën në fjalë.</p> <p>Prezantimi i punëve të grupit do të shoqërohet nga ndërhyrje plotësuese të trajnerit/es, sipas gjykimit të tij/saj, kur të jetë e domosdoshme për të pranishmit.</p>
<b>Materialet e nevojshme</b>	Flipchart, markers, video-projektor, laptop

## Udhëzime për organizimin e trajnimit

### Prezantimi i pjesëmarrësve, i trajnuesit/es dhe i qëllimeve të programit të trajnimit

**Qëllimi:** Të prezantojë pjesëmarrësit me trajnuesin/en, qëllimin dhe programin e trajnimit; të sigurojë “thyerjen e akullit”, ndryshe të krijojë një atmosferë miqësore, të ndryshme nga ajo e klasës në shkollë, duke përcjellë që në fillim të trajnimit qasjen gjithëpërfshirëse, me në qendër pjesëmarrësit.

**Kohëzgjatja:** 30 minuta

**Metodologjia:** Diskutim në grup

#### Hapat:

1. Pjesëmarrësve u kërkohet të intervistojnë njëri-tjetrin me pyetje prezantuese të llojit:
  - Kush jeni e nga vini?
  - Sa vite keni që punoni në profesionin tuaj?
  - A keni marrë pjesë më parë në trajnime të ngjashme?
  - Çfarë prisni nga ky trajnim?
2. Trajnuesi/ja prezanton veten, qëllimin dhe programin e trajnimit.

#### Shënime:

1. Sugjerohet që trajnuesi/ja të mbajë shënim pritshmëritë e pjesëmarrësve në një fletë flipchart në mënyrë që të mund të përshtatë programin me nevojat e dëshirat e tyre.
2. Ky ushtrim shërben edhe për të matur dobishmërinë e trajnimit, duke krahasuar pritshmëritë me vlerësimin përfundimtar të pjesëmarrësve.

## Seanca I. Lloji i planifikimit dhe indikatorët e planifikimit

**Qëllimi:** Të njihen pjesëmarrësit me planifikim vjetor të shkollës dhe indikatorët e matshëm të planifikimit

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Metodologjia:** Rrahje mendimesh

**Hapat:**

1. Trajnuesi/ja iu kërkon pjesëmarrësve të japim mendime individuale në lidhje me elementet që ata i mendojnë të rëndësishme një planifikim të suksesshëm në shkollë.
2. Trajnuesi/ja mban shënim në një fletë flipchart përgjigjet e pjesëmarrësve, duke veçuar: 1) prioritetet 2) treguesit 3) mënyrën e monitorimit të realizimit të prioriteteve.
3. Trajnuesi/ja prezanton format e planifikimit dhe elementet e rëndësishme të planifikimit.

**Shënime:**

Sugjerohet që trajnuesi/ja të bëjë kujdes që:

1. Të marrë mendim nga të gjithë pjesëmarrësit duke nxitur pjesëmarrjen aktive e të barabartë të të gjithëve.
2. Gjithashtu, është e dobishme që trajnuesi/ja t'i kushtojë vëmendje të veçantë qasjes që kanë pjesëmarrësit rreth temës për të cilën diskutohet në mënyrë që ta përshtatë atë me nevojat dhe pritshmëritë e tyre.

**Përmbajtja:**

Elementet e rëndësishme në një trajnim do të prezantohen të ndara në tre kategori:

1. Formati i planeve
2. Indikatorët e matshëm për realizimin e planit
3. Komunikimi i shkollës me komunitetin, prindërit dhe nxënësit



**Tabela 1: Organizimi i aktiviteteve nga shkolla dhe kërkesa ndaj komunitetit**

Aktivitete që ofron shkolla	Datat	Oraret	Mbështeten nga shkolla	Kërkojmë mbështetje nga komuniteti <sup>1</sup>

**Tabela 2: Planifikimi i aktiviteteve nga shkolla dhe komuniteti**

Emri dhe mbiemri i nxënësit	Aktiviteti që do të ndjekë	Datat	Oraret		Emri dhe mbiemri i prindit	Aktiviteti për të cilin ofron mbështetje në mënyrë vullnetare	Datat dhe oraret që propozohen për aktivitetin

**Indikatorët e matshëm për planifikim**

Treguesit duhet të jenë konkretë, t'i përgjigjen kontekstit ku zbatohen dhe të merren parasysh nevojat.

**Monitorimi**

Proces i nevojshëm për t'u realizuar gjatë zbatimit të planit vjetor, por edhe tre-mujor.

---

1. Në dispozita është e rëndësishme të vendoset se sa % duhet të aktivizohet në mënyrë vullnetare secili nga prindërit në shkollë.

## Seanca 2: Karakteristikat e mjedisit, konteksti ku ndodhet shkolla

**Qëllimi:** Njohje me karakteristikat e mjedisit ku ndodhet shkolla, dhe planifikimi për integrimin e komunitetit dhe prindërve në përgjigje të nevojave të shkollës.


**Kohëzgjatja:** 45 minuta

**Metodologjia:** Diskutim dhe prezantim

**Përmbajtja:** Për të organizuar sa më mirë aktivitetet në shkollë është e rëndësishme që të merren në konsideratë dhe faktorët e jashtëm që ndikojnë në realizimin e veprimtarive.



### Objektivat në qendër të filozofisë së programit “Shkolla Qendër Komunitare”



Për arritjen e objektivave është e rëndësishme që shkolla të organizojë një vlerësim të aktiviteteve që ofron, në mënyrë që prindërit të thonë fjalën e tyre në lidhje me pritshmëritë që ata kanë ndaj programit të Shkollës Qendër Komunitare.

## Seanca 3: Mënyrat e menaxhimit për rritjen e efektivitetit dhe cilësisë në shkollë

**Qëllimi:** Llojet e ndryshme të formave të menaxhimit të shkollës.

**Kohëzgjatja:** 45 minuta

**Metodologjia:** Punë në grup dhe prezantim

### Hapat:

1. Trajnuesi/ja i organizon pjesëmarrësit në grupe pune. Secilit grup i jepet një situatë konkrete dhe i kërkohet të japë mënyrat se si do ta menaxhonte situatën për të patur sa më shumë sukses. Trajnuesi diskuton zgjidhjet me të pranishmit.
2. Një përfaqësues i grupit prezanton zgjidhjen/t.
3. Trajnuesi/ja prezanton mënyrat e menaxhimit të suksesshëm.

### Përmbajtja:

Si të drejtojmë SHQK-në për të menaxhuar me efektivitet realizimin e planit të shkollës?

### Roli i drejtuesit:

**Autoritar:** Mobilizon njerëzit drejt një vizioni ose *“ejani me mua”*.

Mbështetja mbi urdhrat apo direktivat që jep drejtuesi i shkollës. Këto urdhra duhen zbatuar pa kërkuar shpjegime. Në një institucion të tillë ndihet një konflikt i heshtur apo një qetësi relative dhe e brishtë që i mbulon problemet. Kemi mosgjetje të zgjidhjeve efektive të problemeve, shkallë të ulët ndërgjegjësimit për detyrat nga stafi, kryerje të detyrave me imponim, mungesë të ndërgjegjësimit të stafit, ekzistencë të shenjave të mendjemadhësisë së drejtuesit, teknika diskriminuese të drejtuesit ndaj stafit, mjedis urdhëruar në shkollë. Në këtë mjedis ka pak vend për diskutime të hapura, debat, vendimmarrje të përbashkët etj.

**Bashkëpunues:** Krijon harmoni dhe ndërton lidhje emocionale, ose “*njerëzit para së gjithash*”.

Shmang hierarkinë, nxit frymën e punës në grup, krijon mundësinë e debatit, konkludimit, diskutimit.

Pasojat pozitive janë:

- tendenca për t'i zgjidhur problemet nëpërmjet tërheqjes së mësuesve në marrjen e vendimeve në shkollë;
- nxitjes së interesit të të gjithë masës së mësuesve për drejtimin në shkollë;
- demonstrim i bashkëpunimit të grupeve në shkollë. Në këtë rast duhet të merret parasysh fakti që edhe për një problem sado të vogël, duhet të merret vendimi i masës dhe disa vendime duhen marrë shpejt dhe në kohë.

**Demokratik:** Kalit marrëveshjen përmes pjesëmarrjes, ose “*si mendoni ju*”.

Kjo formë ka karakteristika shpërndarjen e drejtimit në të gjithë stafin. Vendimmarrja e stafit të shkollës do të thotë marrje pjesë në përcaktimin e objektivave, në planifikimin e veprimtarive të shkollës, në vlerësimin e punës në shkollë.

Ky drejtues nuk ndërhyr në punën e mësuesve, por i drejton ata duke qenë i afërshëm me stafin, duke ndihmuar në arritjen e objektivave të planifikuara, duke qenë miqësor dhe i besueshëm me stafin, duke qenë pikë referimi ku stafi gjen mbështetje pozitive.

**Liberal/atëror:** Përgatit njerëzit për të ardhmen, ose “*provoje këtë*”.

Karakterizohet nga:

- ideja puna le të bëhet, kur të bëhet. Nuk ka kërkesë ndaj stafit të tij;
- drejtimi karakterizohet nga një mos ndjekje rigoroze e objektivave duke ndikuar që këto rezultate edhe po nuk u arritën, kapen vitin tjetër;
- figura e tij nuk ngjall respekt për realizimin e detyrave në shkollë;
- tentojnë kompromisin që të kënaqin dy palët në konflikt.

## Shtojca I. Programi i trajnimit

### Aftësitë e facilitimit

- 9.00 – 9.30 Prezantim i pjesëmarrësve, trajnueses/it dhe qëllimit të programit të trajnimit
- 9.30 – 10.30 **Seanca I.** Lloji i planifikimit dhe indikatorët e planifikimit.
- 10.30 – 11.15 **Seanca II.** Karakteristikat e mjedisit, konteksti ku ndodhet shkolla
- 11.15 – 11.30 Pushim
- 11.30 – 12.15 **Seanca III.** Mënyrat e menaxhimit për rritjen e efektivitetit dhe të cilësisë në shkollë
- 12.15 – 12.45 Pyetje, diskutim dhe përmbyllje
- 12.45 – 13.00 Vlerësimi i trajnimit

Kohëzgjatja e trajnimit do të përshtatet në varësi të nevojave të pranishmëve në trajnim dhe sugjerimeve që do të bëhen nga Save the Children.

## Shtojca II. Formulari i vlerësimit

### Planifikimi i SHQK

Ju lutem, vlerësoni pyetjet e mëposhtme me pikë sipas shkallës në vijim:

- 1 – Aspak e vërtetë
- 2 – Deri diku e vërtetë
- 3 – Nuk e di
- 4 – E vërtetë

1.	Nga ky trajnim mora njohuri të reja.	
2.	Tema e trajnimit ishte e rëndësishme për mua.	
3.	Njohuritë e reja do më shërbejnë në punën time.	
4.	Gjuha e përdorur gjatë trajnimit ishte e qartë dhe e kuptueshme.	
5.	Shembujt e përdorur më ndihmuan të kuptoja temën.	
6.	Trajnuesi/ja i inkurajoi pjesëmarrësit të ishin aktivë.	
7.	Diskutimet mes pjesëmarrësve ishin të dobishme për të kuptuar më mirë njohuritë e reja.	
8.	Trajnuesi/ja kishte njohuri të mira mbi temën.	

9. Për cilën temë/a do të donit të informoheshit më tepër?

---



---



---

10. A do t'ju shërbejnë njohuritë që morët nga ky trajnim? Nëse po, si?

---



---



---

## **MODUL TRAJNIMI**

# **ROLI I BORDIT TË SHKOLLËS DHE I KOMUNITETIT NË SHNDËRRIMIN E SHKOLLËS NË QENDËR KOMUNITARE**

**Tiranë, mars 2015**



## Përmbajtja

<b>Tema e çdo seance:</b> .....	17
<b>Përfituesit nga trajnimi</b> .....	17
<b>Rezultatet e pritshme</b> .....	17
<b>Metodologjia:</b> .....	18
<b>Mjetet</b> .....	18
<b>Literatura e rekomanduar për të trajnuarit</b> .....	18
<b>Përshkrimi i përmbajtjes</b> .....	18
<b>Seanca I</b> .....	20
<b>Seanca II</b> .....	24
<b>Seanca III</b> .....	28

## Titulli: Roli i bordit të shkollës dhe i komunitetit në shndërrimin e shkollës në qendër komunitare

**Qëllimi:** Ngritja e kapacitetit të anëtarëve të bordeve të institucioneve arsimore për mirëfunksionimin e bordit dhe kryerjen me efektivitet të veprimtarive në kuadrin e shkollës si qendër komunitare.

### Tema e çdo seance:

**Seanca 1:** Rëndësia e pjesëmarrjes së prindërve dhe e komunitetit në vendimmarrjen dhe menaxhimin e institucionit arsimor.

**Seanca 2:** Hapat për krijimin e bordit të shkollës, roli i tij, objekti i punës dhe veprimtaritë.

**Seanca 3:** Roli i bordit, i komunitetit dhe i organizmave të tjerë në nxitjen e transformimit të shkollës si qendër komunitare.

### Përfituesit nga trajnimi:

- Specialistë të DAR/ZA-ve
- Drejtues të institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar
- Mësues të arsimit të detyruar
- Mësues të gjimnazit
- Nxënës në arsimin parauniversitar

### Rezultatet e pritshme:

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit:

- kanë kuptuar se sa e rëndësishme është pjesëmarrja e prindërve dhe e komunitetit në veprimtarinë e institucionit arsimor;
- kanë zhvilluar aftësitë e duhura për të gjetur rrugët e përfshirjes së prindërve dhe përfaqësuesve të komunitetit në vendimmarrjen dhe menaxhimin e institucionit;
- kanë zhvilluar aftësitë për të vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe mbështetjes së prindërve dhe komunitetit nga ana e mësuesve dhe drejtuesve;
- kanë vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit të bordit të shkollës me organizmat e tjerë brenda dhe jashtë shkollës.

## Metodologjia:

Rezultatet e përmendura më sipër do të arrihen nga pjesëmarrësit duke bërë një gërshetim të parashtrimit në nivel teorik të koncepteve kryesore të përmbajtjes, diskutimeve të hapura dhe në grup të pjesëmarrësve, si dhe përmes veprimtarive praktike të realizuara përgjatë seancave.

### **Metodat gjatë trajnimit.**

- **Leksioni**, përmes të cilit trajtohen konceptet kryesore që përmban moduli, të cilat janë përmendur në përmbledhjen e modulit.
- **Diskutimi**, përmes të cilit në disa raste me gjithë grupin apo në raste të tjera në grupe të vogla diskutohet për çështje si: *Cilat janë mënyrat e përfshirjes së prindërve në veprimtarinë e shkollës? Cilat janë organizmat brenda shkollës dhe jashtë saj, ku mund të luajë rol pjesëmarrja e prindërve dhe e përfaqësuesve të komunitetit?* etj.
- **Punë në grupe**. Gjatë trajnimit do të zhvillohen veprimtari praktike ku pjesëmarrësit të ndarë në grupe do të identifikojnë mundësitë e pjesëmarrjes së prindërve në vendimmarrjet e shkollës, bordin e prindërve, këshillin e mësuesve, këshillin e prindërve, komisionin e etikës dhe sjelljes etj.

## Mjetet

Secili pjesëmarrës do të pajiset me paketën e modulit bashkë me fletë-pune. Të tilla janë nene të shkëputura nga Dispozitat Normative që lidhen me pjesëmarrjen e prindërve, udhëzimi për bordin e shkollës, standardet e SHQK-së etj.

Nga trajneri do të përdoret gjatë gjithë trajnimit projektor, kompjuter. Në veprimtaritë praktike do të përdoren tabakë muri, markera, ngjitës etj.

### **Literatura e rekomanduar për të trajnuarit**

- Moduli i përgatitur nga trajneri
- Dispozitat Normative për arsimin parauniversitar, 2013
- Udhëzimi i MAS-it “ Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- Standardet e shkollës si qendër komunitare, MAS 2014
- Udhëzuesi në ndihmë të SHQK, IZHA 2014

### **Përshkrimi i përmbajtjes.**

Ky modul trajton konceptin e pjesëmarrjes së prindërve dhe të komunitetit në

veprimtarinë e institucionit arsimor. Në këtë pjesë theksohet dhe diskutohet me pjesëmarrësit se pjesëmarrja e prindërve dhe e komunitetit i referohet mekanizmave të ndryshëm që përdoren me qëllim që ata të shprehin opinionet e tyre dhe mundësisht të ndikojnë mbi vendimet e marra brenda institucionit. Materiali i shkruar e përkufizon pjesëmarrjen e prindërve si një proces përmes të cilit ata veprojnë në përgjigje të shqetësimeve të tyre, shprehin opinionet e tyre mbi vendimet që ndikojnë mbi ta dhe marrin përgjegjësi për të sjellë ndryshime në të mirë të komunitetit të shkollës.

Më pas përgjatë modulit kalohet në format e përfshirjes së prindërve dhe komunitetit në veprimtarinë e shkollës. Një nga gjërat kryesore që trajtohen janë llojet e këtyre formave si:

- **konsultim** në procesin e marrjes së vendimeve që ndikojnë drejtpërdrejt mbi fëmijët;
- **bashkëpunim** që të jesh partner me drejtuesit, mësuesit dhe prindërit në çdo aspekt të vendimmarrjes përfshirë zhvillimin e alternativave dhe identifikimin e zgjidhjeve të preferuara. Bashkëpunimi është efektiv veçanërisht në procesin e zbatimit të vendimeve që prekin drejtpërdrejt fëmijët;
- **përfshirje** e cila është shumë më e gjerë se dy format e lartpërmendura dhe nënkupton angazhimin e prindërve në të gjitha hallkat e marrjes së vendimeve nga autoritetet arsimore dhe të shkollës, përcaktimin e prioritetëve, formulimin e vendimit, zbatimin dhe monitorimin e vendimit.

Duke u nisur nga dokumente të rëndësishme si Ligji për arsimin parauniversitar dhe Dispozitat Normative, në modul theksohen të gjitha ndryshimet dhe funksionet që u atashohen prindërve, bordit të prindërve dhe këshillit të prindërve, referuar këtyre dokumenteve. Në modul theksohet se funksionimi i bordit të shkollës krijon një mentalitet të ri për pozicionin dhe rolin e prindërve në shkollë, duke i parë ata si partnerë dhe pjesëmarrës aktivë në proceset e vendimmarrjes në shkollë dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Roli i mësuesit apo drejtuesit koordinator i shkollës si qendër komunitare është një pjesë tjetër e përmbajtjes së modulit. Ai është aktor shumë i rëndësishëm në mbarëvajtjen dhe bashkëpunimin me prindërit dhe përfaqësuesit e komunitetit për të ndihmuar dhe këshilluar kryesisht në hartimin dhe zbatimin e planit të veprimtarive, përfshirë edhe menaxhimin e fondeve.

Përthyerja e përmbajtjes së modulit në mjedisin e trajnimit shoqërohet edhe me veprimtari praktike ku pjesëmarrësit përmes demonstrimeve, diskutimeve në grup trajtojnë aspekte të ndryshme të bashkëpunimit dhe mbështetjes së qeverisë së nxënësve.

## Seanca I

**Rëndësia e pjesëmarrjes së prindërve dhe e komunitetit në vendimmarrjen dhe menaxhimin e institucionit arsimor. E drejta e prindërve për të formuar bordin e tyre.**

**Qëllimi:** Të njihen pjesëmarrësit me rëndësinë e pjesëmarrjes së prindërve dhe të komunitetit në veprimtarinë e institucionit arsimor.

**Kohëzgjatja:** 45 minuta

**Metodologjia:** Leksion, diskutim dhe rrahje mendimesh, punë në grupe

### Hapat:

1. U kërkohet pjesëmarrësve të kujtojnë një nga veprimtaritë e fundit të shkollës së tyre ku është dashur të jenë pjesë apo të kryejnë punën.
2. Prezantohen të drejtat dhe detyrimet e prindërve në lidhje me pjesëmarrjen në veprimtaritë e shkollës (*Dispozitat Normative dhe prindërit*).
3. Pjesëmarrësit diskutojnë dhe në grup përcaktojnë detyrimet e tyre në lidhje me veprimtaritë e institucionit arsimor.

### Përmbajtja:

Sot kërkohet që çdo shkollë në qytet apo në fshat të hartojë një politikë të caktuar për përfshirjen e prindërve në edukim. Hartimi i një politike dhe i një plani për përfshirjen e prindërve në edukim, si dhe zbatimi i tyre ka shumë rëndësi, sepse nga kjo gjë përfitojnë fëmijët, shkolla dhe prindërit. Sidoqoftë edhe në rastet kur në shkollë ekziston një politikë dhe plan zhvillimi për partneritetin shkollë-familje, ajo që ka rëndësi është se çfarë ndodh aktualisht në këtë shkollë.

Për të hartuar një plan për zhvillimin e partneritetit shkollë- familje:

- Komunikoni me gojë ose me shkrim me çdo prind për të parë se çfarë mendojnë ata për shkollën dhe se çfarë do të pëlqenin të përmbanin programet e përfshirjes së tyre në edukim.

- Mësoni sesi e kuptojnë anëtarët e bordit të shkollës dhe vetë stafi i shkollës përfshirjen e prindërve në edukim.
- Vlerësoni programet aktuale që ka shkolla për përfshirjen e prindërve në shkollë dhe mënyrën sesi funksionojnë ato, duke i vendosur veprimtaritë në një plan për zhvillimin e partneritetit shkollë- familje.

Grumbulloni informacion për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

- A ka organizuar shkolla juaj një politikë apo strategji për përfshirjen e prindërve në edukim?
- A ka programi juaj një shpërndarje të barabartë të mundësive për të përfshirë të gjitha kategoritë e prindërve në edukim? Në qoftë se jo, cila nga kategoritë e prindërve kërkon më shumë mbështetje?
- A janë përfshirë në programin tuaj prindër që përfaqësojnë çdo grup të madh familjar të komunitetit të shkollës?
- A janë përfshirë në programin tuaj prindër që kanë fëmijë në klasa të ndryshme apo prindër vetëm nga një klasë?

*Për të ndihmuar në formimin e partneritetit shkollë-familje:*

1. Punoni për hartimin e një politike për përfshirjen e prindërve në edukim. Ndhmoni që politika e përfshirjes së prindërve në edukim të zbatohet në shkollën tuaj.
2. Bëni një fushatë për përfshirjen e prindërve në edukim. Përfshini në këtë fushatë prindër dhe nxënës.
3. Pyesni prindërit se çfarë programesh ose seminaresh kanë interes të ndjekin. Kini parasysh që problemi qendror është të ndihmohet prindi për t'u bërë më efektiv në punën me fëmijët. Programet mund të përfshijnë veprimtari që ndihmojnë prindërit për të rritur aftësitë e tyre në rolin e prindit apo për të siguruar informacione rreth çështjeve, të cilat kanë lidhje me komunitetin e prindërve.
4. Siguroni libra me temë për punën me prindërit dhe i vendosni këto libra në bibliotekë ose në klasat e shkollës. Ftoni prindërit që të marrin lirisht libra ose të kërkojnë materiale të tjera.
5. Në qoftë se ka mjedise fizike në shkollë, hapni një dhomë për prindërit dhe vendosni literaturën për ta, siç u tha më sipër. Ftoni njerëz nga shkolla apo komuniteti për t'u lidhur me veprimtaritë e edukimit të prindërve Përdoreni dhomën si një vend që u shërben nevojave të prindërve.

6. Mendoni mënyra për të tërhequr të gjithë prindërit në shkollë. Përdorni prezantimet verbale dhe vizuale për të qartësuar informacionin teorik.

Kur prindërit përfshihen në edukimin e fëmijëve, atëherë fëmijët kanë rezultate më të mira në mësim. Nuk ka nevojë që prindërit të kenë një arsimim të lartë. Ajo që nevojitet është që ata të krijojnë një atmosferë familjare, që u thotë fëmijëve të tyre se shkollimi është i rëndësishëm dhe se ata kërkojnë që fëmijët të mësojnë mirë, për këtë ata do t'i ndihmojnë në shkollë dhe në shtëpi.

*Çfarë mund të bëni ju si mësues që shkolla dhe prindërit të komunikojnë vazhdimisht me njëri tjetrin?*

Kërkoni nga prindërit që:

- kur ka ndonjë kërkesë nga shkolla ta plotësojnë atë dhe ta dërgojnë përsëri në shkollë. Stafi i shkollës ka nevojë të dëgjojë mendimet e prindërve;
- të informojnë shkollën për gjërat që u ndodhin në shtëpi dhe që mund ta bëjnë fëmijën të jetë i mërziur apo i zemëruar në shkollë.

*Çfarë mund të bëjë prindi për fëmijën dhe për shkollën?*

- Krijoni kushte për një zhvillim të mirë fizik dhe emocional të fëmijës suaj.
- Krijoni një mjedis të tillë në shtëpi që të tregoni se shkollimi vlerësohet dhe inkurajoni procesin e të mësuarit.
- Krijoni në shtëpi një atmosferë që inkurajon respektin e dyanshëm dhe komunikimin.
- Merrni pjesë si vullnetar në shkollë ose në klasën e fëmijës tuaj në veprimtari të ndryshme.
- Ndiqni të gjitha veprimtari të shkollës.

*Çfarë mund të bëni ju si mësues?*

Ndihmoni prindërit:

- të njohin programin e shkollës: çfarë mëson fëmija në shkollë, pse dhe si funksionon sistemi shkollor, si mund ta ndihmojnë fëmijën të mësojë, si dhe të njohin të drejtat dhe përgjegjësitë prindërore;
- të mësojnë sesi ndodh zhvillimi fizik, mendor dhe social i fëmijës nga

foshnjëria gjer në moshën e rritur;

- të kenë të qartë se çfarë presin nga fëmijët e tyre dhe se si do të njoftohen për përparimin e tyre;
- të kujtojnë se ata janë mësuesit e parë dhe më të rëndësishëm që i pajisin fëmijët me shprehitë që u duhen atyre në jetën e përditshme si: përgjegjësia, vendosmëria, shprehitë për t'u shoqëruar me të tjerët etj.;
- që t'ju japin informacion për fëmijët e tyre, si dhe për eksperiencat e tjera që mund t'ju interesojnë;
- dhe u kërkoni atyre që t'ju bëjnë të qarta nevojat që ata kanë;
- dhe i inkurajoni që të marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve dhe në zgjidhjen e problemeve që ka shkolla. Në qoftë se zëri i prindërve nuk dëgjohet shumë në shkollë dhe prindërit e interesuar nuk kanë mundësinë të marrin pjesë në mënyrë efektive në punët e saj, bisedoni me drejtorin për të iniciuar veprimtari që çojnë në një përfshirje më të madhe të prindërve në punët e shkollës.



## Seanca II

### Hapat për krijimin e bordit të shkollës, roli i tij, objekti i punës dhe veprimtaritë.

**Qëllimi:** Të njihen pjesëmarrësit me veçoritë kryesore të ngritjes dhe funksionimit të një bordi shkolle efektiv që bashkëpunon dhe luan rol në veprimtarinë e institucionit arsimor.

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Metodologjia:** Leksion, diskutim dhe rrahje mendimesh, punë në grupe

#### Hapat:

1. Zhvillohet një brainstorming me pjesëmarrësit mbi faktin se cili është roli i bordit të shkollës në institucionin arsimor. Mendimet e pjesëmarrësve shënohen në tabakë muri dhe qëndrojnë në mjedisin e trajnimit.
2. Prezantohen ngritja dhe funksionimi i bordit të shkollës duke iu referuar Ligjit për arsimin parauniversitar si dhe Dispozitave Normative.
3. Pjesëmarrësit diskutojnë dhe në grup përcaktojnë detyrimet e anëtarëve të bordit në lidhje me veprimtaritë e shkollës si qendër komunitare.

#### Përmbajtja:

Ndryshimi i sistemit solli edhe ndryshimin e botëkuptimit të prindërve dhe të komunitetit mbi arsimin dhe edukimin. Kjo bëri që të ndryshojnë raportet e marrëdhënieve midis prindërve, por dhe midis tyre, shkollës e qeverisë. Në këto raporte morale, shoqërore, politike dhe ligjore, duhen parë dhe përgjegjësitë e edukimit. Këto përgjegjësi e kanë burimin në përcaktimin se kush vendos për qëllimet e edukimit dhe drejtimet e tij, për programet e tekstet mësimore, për metodat e zbatimit të tyre apo dhe në ç'kushte do të realizohen. Në marrëdhënien e krijuar duhen përcaktuar dhe rolet; cili është roli i qeverisë, i prindërve dhe komunitetit, i mësuesve dhe shkollës, pasi dihet se sfida që has çdo shoqëri është të përcaktojë ekuilibrin e saktë të autoritetit dhe kontrollit të secilit.

Shkolla, më shumë se çdo institucion tjetër e ka të domosdoshëm reformimin dhe ndryshimin. Që ndryshimi të ketë vlerë ose kahe pozitive duhen angazhuar të gjithë “aktorët” e jetës shkollore. Vitet e fundit të gjitha urdhrat, udhëzimet apo përparësitë në sistemin arsimor kanë patur në fokus të tyre krijimin e një shkolle me frymë realisht demokratike dhe bashkëkohore. Disa prej tyre i kanë dhënë hapësira dhe kompetenca organeve kolegjiale në shkollë. Kështu është bërë më aktiv senati i shkollës, funksionimi i të cilit i bën nxënësit më të përgjegjshëm në liritë dhe të drejtat e tyre. Me të njëjtën cilësi mund të flasim edhe për bordin e shkollës, këshillin e prindërve të klasave, këshillin e prindërve të shkollës etj.

I vetmi organ kolegjial që ka në përbërjen e tij të gjithë “grupet e interesit” në shkollë është bordi i saj. Pas viteve ‘90 u formatuan dhe u ngritën bordet nëpër të gjitha shkollat sipas rregullave që përcaktonin Dispozitat Normative. Me gjithë arritjet pozitive, sërisht bordet ishin larg asaj që duhej të arrinin në dobi të shkollës. Suksesi i një bordi filloi të matej me kontributet monetare që siguroheshin për shkollën. “Të preferuarit” në përbërje të bordit ishin kryesisht biznesmenët. Sponsorizimet dhe donacionet e tyre ishin vërtet të nevojshme për shkollën, por u anashkaluan dhe u harruan funksionet e tjera të bordit si: bashkëpunimi me pushtetin vendor dhe komunitetin, mbështetja në realizimin e objektivave themelore të veprimtarisë së shkollës dhe problemeve që shqetësojnë shkollën etj. Kësisoj ndjehej e nevojshme një formatim dhe konceptim më bashkëkohor i bordit të shkollës. Pas diskutimesh me mësues, prindër, drejtues shkolle dhe specialistë në arsim si dhe studimi i përvojave botërore me datë 17.10.2007 doli udhëzimi nr. 40 i MASH “Për ngritjen e funksionimin e bordit të shkollës”.

Në **Ligjin** Nr. 69/2012 datë 26.06.2012, në nenin 34, lidhur me Bordin e institucionit arsimor është shkruar:

1. Çdo institucion arsimor ka bordin e tij të përbërë nga prindër, nxënës, mësues, përfaqësues të qeverisë vendore dhe të komunitetit. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor dhe i raporton për veprimtarinë e tij këshillit të prindërve të institucionit.
2. Detyrat kryesore të bordit janë:
  - miraton planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit;
  - miraton planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni;
  - miraton kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor;
  - merr pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të drejtorit të institucionit arsimor dhe të mësuesit.

3. Përbërja e bordit, të drejtat, detyrat e tjera dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve përcaktohen në udhëzimin e ministrit.

### **Përbërja e bordit**

Bordi i shkollës është ngritur për të ndikuar që shkolla ta bëjë më mirë punën e saj.

- Prindërit janë në bord që shkolla ta bëjë punën aq mirë sa ç'dëshirojnë prindërit për fëmijët e tyre.
- Nxënësit janë në bord që shkolla ta bëjë punën aq mirë sa ç'dëshirojnë nxënësit.
- Përfaqësuesi i DAR është aty që shkolla ta bëjë punën aq mirë sa ç'dëshiron ministria.
- Përfaqësuesi i qeverisë lokale është aty që shkolla ta bëjë punën aq mirë sa ç'dëshiron bashkia ose komuna.

Sipas udhëzimit nr. 27, datë 02.08.2013, përbërja e bordit është:

	Bordi	Mësues	Nxënës	Prind	Komunitet	Vendor
>24 klasa	5	1	1	1	1	1
<24 klasa	7	1	2	2	1	1

Ndodh rëndom që risitë (edhe kur këto janë të domosdoshme) priten me dyshim e më së pakti me frikë. Ky ishte reagimi i “bazës” pas daljes së udhëzimit. Ajo që u duk pak më e vështirë për t'u përtypur ishte mungesa e drejtorit të shkollës në bord. Për shumëkënd drejtori është kryefjala në çdo veprimtari të shkollës, është motori që vë në lëvizje të gjithë mekanizmat e tjerë. Kjo ishte kthyer në metodë pune ose mendësi edhe tek disa drejtorë. Jo për të patur gjithçka nën kontroll, por më shumë nga shqetësimi që vetëm duke qenë vetë në krye mund të mirëfunksiononte bordi. E njëjta gjë ka ndodhur edhe kur në shkollë u “instalua” senati i shkollës. Me logjikë të ftohtë kupton që mospërfshirja e drejtorit sipas udhëzimit në përbërjen e bordit bën të mundur një vendimmarrje më të paanshme, shmang gabimet e mundshme njerëzore (duke e copëzuar pushtetin) dhe i bën më të besueshme vendimet dhe të gjithë veprimtaritë e bordit. Megjithatë titullari i shkollës nuk është krejtësisht i zhveshur nga detyrimet kundrejt bordit. Roli i tij është shumë i rëndësishëm, gati vendimtar, në krijimin e terrenit të përshtatshëm për krijimin e bordit. Është detyrë dhe në interes të tij të kujdeset për zgjedhjen e mësuesit nga këshilli pedagogjik, të informojë senatin dhe çdo nxënës e prind të shkollës për funksionet e bordit të shkollës.

Disa nga detyrimet e drejtorit të shkollës ndaj bordit janë:

- t'i paraqesë bordit për miratim:
  - planin vjetor të shkollës;
  - planin financiar;
  - rregulloren e shkollës.
- t'i raportojë bordit për aspekte të veprimitarisë së shkollës kur këtë e kërkon bordi;
- t'i dorëzojë bordit nga një kopje:
  - të planit vjetor;
  - të planit të shpenzimeve vjetore;
  - të rregullores së shkollës;
  - të udhëzimeve të ministrit, të DAR ose të qeverisë lokale;
  - të raporteve të inspektimit;
  - të dokumenteve të tjera që bordi mund të kërkojë, si p.sh. raportin e analizës vjetore të shkollës.
- të marrë pjesë në mbledhjet e bordit sa herë bordi ta kërkojë këtë;
- t'i sigurojë mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e mbledhjeve të bordit;
- t'i sigurojë ruajtjen e arkivës së bordit;
- të ftojë kryetarin e bordit dhe anëtarët e tij në ceremoni ose veprimtari të të gjithë shkollës;
- të ftojë kryetarin e bordit në analizën semestrale dhe vjetore të shkollës etj.

## Seanca III

### Rëndësia e pjesëmarrjes së prindërve dhe i komunitetit në vendimmarrjen dhe menaxhimin e institucionit arsimor.

**Qëllimi:** Të njihen pjesëmarrësit me rolin e pjesëmarrjes së prindërve dhe të komunitetit në shndërrimin e shkollës si qendër komunitare.

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Metodologjia:** Leksion, diskutim dhe rrahje mendimesh, punë në grupe

#### Hapat:

1. Prezantohet koncepti i shkollës si qendër komunitare, standardet e saj, si dhe llojet e veprimtarive në këtë kuadër.
2. Pjesëmarrësit sjellin shembuj dhe diskutojnë për lloje veprimtarish të zhvilluara në shkollë ku ata kanë qenë pjesëmarrës apo kanë patur rol aktiv.
3. Hartimi i planit të veprimtarive të shkollës në kuadrin e shkollës qendër komunitare. Roli i prindërve dhe llojet e veprimtarive që zhvillohen më prindërit dhe përfaqësuesit e komunitetit.

#### Përmbajtja:

Kërkimet dhe përvojat e praktikantëve të suksesshme kanë provuar se përfshirja e prindërve është çelësi për të ndihmuar fëmijët të jenë të suksesshëm në shkollë. Ata bëhen më të mirë atëherë kur prindërit e tyre kujdesen rreth asaj që ata janë duke bërë në shtëpi, në komunitet dhe në shkollë.

Përfshirja e prindërve në të gjitha aspektet e jetës së fëmijës është shumë e rëndësishme. Fëmijët mund të arrijnë të shfaqin plotësisht potencialin e tyre në shkollë ose në jetë vetëm kur plotësohen nevojat e tyre fizike dhe emocionale. Ata kanë nevojë që të mësojnë të ndihen mirë me veten e tyre, të mësojnë sesi të marrin vendime dhe të jenë përgjegjës për rezultatet e këtyre vendimeve.

## Çfarë është përfshirja e prindërve në shkollë

Në kuptimin e gjerë të fjalës, përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim të ndihmojë prindërit që të kuptojnë më mirë se çfarë është:

- Prindërimi (të qenit prind)- shprehitë që përdorin prindërit për të rritur dhe edukuar fëmijët e tyre.
- Edukimi i prindërve - informacioni rreth çështjeve që mund të ndikojnë në jetën e fëmijëve të tyre.
- Përfshirja e prindërve në procesin mësimor - rrugët e ndryshme për të mbështetur fëmijët e tyre në shkollë, si dhe për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes lidhur me procesin mësimor dhe të funksionimit të shkollës.

Përfshirja e prindërve në edukim është një koncept i gjerë, sepse shfaqet në shumë forma dhe realizohet në shumë mënyra. Mjaft materiale teorike përshkruajnë role të ndryshme që prindërit mund të luajnë në edukimin e fëmijëve të tyre:

### *Prindërit si partnerë*

Që në momentin e lindjes së fëmijës prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes janë edukatorët e parë dhe kryesorë të tij. Në shtëpi fëmijët mësojnë si të bisedojnë dhe të zhvillojnë aftësitë gjuhësore, mësojnë vlerat, shprehitë sociale, si dhe marrin njohuri për shoqërinë.

Prindërit kanë përgjegjësi ligjore për regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë, si dhe për frekuentimin e rregullt të saj. Ata duhet t'i përgjigjen kërkesave dhe informacioneve të ndryshme që vijnë nga shkolla.

Prindërit kanë të drejtë ligjore të njihen me të gjitha rezultatet shkollore të fëmijëve të tyre, të ndjekin sjelljen e fëmijëve dhe të përfshihen në vendimet që merren për edukimin e tyre.

Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?

- Ndihmon prindërit për të kuptuar përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre.
- Jep informacion për:
  - rëndësinë që ka ndjekja e shkollës rregullisht nga fëmija;
  - rregullat dhe procedurat shkollës, duke treguar edhe mënyrat sesi zbatohen ato;
  - programet e shkollës dhe përmbajtjen e fushave të ndryshme kurrikulare.

### *Prindërit si partnerë dhe zgjidhës të problemeve të shkollës*

Prindërit mbështesin punën që bën shkolla me fëmijët e tyre dhe ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve. Prindërit mund të demonstrojnë sesa e rëndësishme është shkolla nëpërmjet disa lloj angazhimesh dhe shfaqje interesash:

- Reagimi ndaj mungesave, sëmundjeve të lehta të fëmijëve, si dhe braktisjeve të shkollës.
- Rregullat e vëna për fëmijët e tyre rreth kohës së gjumit dhe asaj për të shikuar televizorin.
- Vlerësimi i rëndësisë së detyrave të shtëpisë.
- Mënyrat sesi ata mbështesin përpjekjet e fëmijëve për të dhënë maksimumin në shkollë.
- Inkurajimi i sjelljeve pozitive të fëmijëve.

Shumë rrallë ndodh që shkolla të zgjidhë e vetme problemet e të nxëniet ose të sjelljes së fëmijëve. Në shumicën e rasteve, ju dhe prindërit punoni së bashku për të zgjidhur problemet aktuale që kanë fëmijët në shkollë.

*Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?*

- Të sigurojë materiale dhe të iniciojë programe apo trajnime që ndihmojnë prindërit të kuptojnë rregullat dhe procedurat shkollore.
- Të vërë në dukje rëndësinë e komunikimit të prindërve me mësuesit.
- Të vlerësojë rëndësinë e pjesëmarrjes së prindërve në mbledhjet që organizon shkolla.
- Të iniciojë programe për t'u mësuar prindërve sesi t'i ndihmojnë fëmijët në kryerjen e detyrave të shtëpisë.

### *Prindërit si vëzhgues*

Në këtë rol prindërit ndjekin dhe vlerësojnë veprimtaritë e shkollës dhe të fëmijëve. Veprimtaritë shkollore dhe pas shkolle si: lojërat, shfaqjet artistike, koncertet, aktivitetet sportive, veprimtaritë letrare, shkencore etj., janë elemente, të cilat mbushin hendekun ndarës që ekziston midis shtëpisë dhe shkollës. Vizitat në klasë i njohin prindërit më mirë me punën që bën mësuesi me nxënësit, me atmosferën e klasës dhe shokët me të cilët kanë miqësi fëmijët e tyre. Në kohën që prindërit qëndrojnë në shkollë për të dëgjuar dhe vëzhguar fëmijët e tyre ata mund edhe të mbledhin

informacion për veprimtaritë e shkollës dhe njerëzit me të cilët fëmijët e tyre harxhojnë një pjesë të kohës. Me rëndësi është fakti që në këto vizita fëmijët në përgjithësi dhe ata me rezultate të ulta në veçanti, ndihen mirë që prindërit e tyre tregojnë interes për shkollën, mësuesit dhe klasën e tyre.

Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?

- Merr pjesë në planifikimin dhe njoftimin e veprimtarive të shkollës, duke ua bërë të njohura prindërve.
- Bën prindërit pjesë të veprimtarive, si dhe takimeve që zhvillon stafi mësimor ose klasa.
- Organizon veprimtari të ndryshme duke vendosur një plan të alternuar për orarin, ditët e pushimit dhe pasditet për t'u dhënë mundësi të gjithë prindërve të ndjekin këto veprimtari.

### *Prindërit si vullnetarë*

Në këtë rol prindërit punojnë si vullnetarë në ndihmë të shkollës, mësuesve, bordit të shkollës, këshillit të prindërve etj. Në shumë praktika të suksesshme ka një traditë që prindërit të punojnë vullnetarisht në ndihmë të mësuesve të fëmijëve të tyre dhe të shkollës në tërësi.

### *Prindërit si këshillues dhe partnerë në vendimmarrje*

Prindërit japin ndihmesën e tyre në politikën e shkollës dhe planet e programet shkollore nëpërmjet pjesëmarrjes si në bordin e shkollës dhe në institucionet ato vendimmarrëse. Shumë prindër marrin pjesë në bordin e shkollës, këshillin e mësuesve duke krijuar mundësinë që të lidhen me problemet e shkollës dhe veprimtaritë që realizohen aty. Kjo i bën që të kenë një autoritet real në vendimmarrje. Sot ka një prirje për t'i përfshirë prindërit në bordet e shkollës me synimin që ata të marrin vendime për çështje të ndryshme të shkollës si dhe për emërimin e stafit mësimor.

Kur prindërit kalojnë nga roli i një këshilluesi në atë të një vendimmarrësi, atëherë ata kanë nevojë për më shumë informacion. Ata kanë nevojë të mësojnë teknika për të bërë pjesë të vendimmarrjes problemet që janë ngritur në komunitet nga prindërit. Trajnimet e prindërve janë të vlefshme, sepse ata do të njohin më mirë programet edukative të shkollës dhe do të jenë të ndjeshëm ndaj nevojave arsimore të fëmijëve dhe prindërve në komunitetin e tyre shkollor.



## Shtojcë 1: Programi i trajnimit

Veprimtaria	Koha
<p><i>Hyrje</i></p> <p>Prezantimi i pjesëmarrësve. Mirëseardhja e pjesëmarrësve dhe prezantimi me grupin e trajnimit. Prezantimi i objektivave të trajnimit.</p>	<b>9.00 - 9.30</b>
<p><i>Diskutim dhe brainstorming</i></p> <p>Roli i secilit pjesëmarrës në nismën shkolla si qendër komunitare.</p>	<b>9.30 – 10.00</b>
<p>Rëndësia e pjesëmarrjes së prindërve dhe komunitetit në vendimmarrjen dhe menaxhimin e institucionit arsimor.</p>	<b>10.00 – 11.00</b>
<p><i>Pushim</i></p>	<b>11.00 – 11.30</b>
<p>Hapat për krijimin e bordit të shkollës. Roli i tij, objekti i punës dhe veprimtaritë. Listimi i detyrave të bordit dhe diskutim i mundësive konkrete që ka bordi në lidhje me marrëdhëniet me shkollën, pushtetin lokal dhe komunitetin.</p>	<b>11.30 – 12.30</b>
<p>Roli i bordit, komunitetit dhe organizmave të tjerë në nxitjen e transformimit të shkollës si qendër komunitare.</p>	<b>12.30 – 13.30</b>
<p><i>Mbyllja</i></p> <p>Mbyllja e trajnimit, vlerësimi dhe detyra në vazhdim për të siguruar vazhdimësinë e trajnimit.</p>	<b>13.30 – 14.00</b>

## Shtojcë 2: Format vlerësimi për trajnimin

Cilat ishin 3 gjërat më të vlefshme për të cilat mësuar në këtë trajnim?

---



---



---

Cilat ishin 2 gjërat më pak të vlefshme në këtë trajnim?

---



---

Shëno sa i kënaqur ke mbetur nga ky trajnim duke konsideruar:

(1- shkëlqyeshëm, 2- shumë mirë, 3- mirë, 4- mjaftueshëm, 5- ka nevojë për përmirësim)

stilin dhe mënyrën e konceptimit të trajnimit	1	2	3	4	5
përmbajtjen e trajnimit	1	2	3	4	5
dobinë e diskutimeve	1	2	3	4	5
përgatitjen dhe aftësitë e trajnerëve	1	2	3	4	5

Nëse do të përgatiteshin trajnime të tjera për ju dhe për prindër të tjerë, thuaj dy tema që do të ishin më me shume interes?

---



---



---



---

**Ju faleminderit!**



## **MODUL TRAJNIMI**

# **NXITJA E PJESËMARRJES SË FËMIJËVE NË VENDIMARRJEN E PËRBASHKËT NË SHKOLLËN QENDËR KOMUNITARE**

**Tiranë, mars 2015**

## Tabela e përmbajtjes

- <b>Përshkrim i përgjithshëm i modulit</b> .....	37
- <b>Seanca 1:</b> Roli i organizmave të nxënësve në shkollë në kuadrin e SHQK-së.....	39
- <b>Seanca 2:</b> Bashkëpunimi i nxënësve me aktorë dhe partnerë të shkollës, format e bashkëpunimit .....	43
- <b>Seanca 3:</b> Planifikimi i veprimtarive të nxënësve .....	47
- <b>Shtojca</b> .....	50

## PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I MODULIT

Moduli “Nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimarrjen e përbashkët në shkollën qendër komunitare” është pjesë e paketës së moduleve trajnuese që shërbejnë për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve për funksionimin e shkollës si qendër komunitare. Ky modul i adresohet grupeve të ndryshme të interesit, si: mësues, drejtues shkollash dhe koordinatorë të shkollës qendër komunitare. Fokus i veçantë dhe i drejtpërdrejtë i këtij moduli janë nxënësit dhe organizmat përfaqësues të nxënësve në shkollë, të cilët duhet të njohin dhe të mbajnë qëndrim për çështjet dhe problematikat sociale të komunitetit. Nxënësit duhet të kuptojnë dhe të binden se edhe ata mund të jenë aktorë të ndryshimit në shkollë, në komunitet dhe më gjerë në shoqëri. Ata kanë nevojë që të mësojnë sesi të marrin vendime dhe të jenë përgjegjës për rezultatet e këtyre vendimeve.

<b>Tema e trajnimit</b>	Nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimarrjen e përbashkët në shkollën si qendër komunitare.
<b>Nëntemat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Roli i organizmave të nxënësve në shkollë në kuadrin e SHQK-së.</li> <li>- Bashkëpunimi i nxënësve me aktorë të ndryshëm në shkollë dhe format e bashkëpunimit.</li> <li>- Planifikimi i veprimtarive të qeverive të nxënësve në kuadër të SHQK-së.</li> </ul>
<b>Qëllimi</b>	Aftësimi i nxënësve për të zhvilluar rolin e tyre aktiv në veprimtaritë e shkollës si qendër komunitare.
<b>Rezultatet e pritshme</b>	<p>Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- japin kuptimin e tyre për rolin e organizmave të nxënësve në shkollë në kuadrin e SHQK-së;</li> <li>- identifikojnë format e bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm;</li> <li>- demonstrojnë shembuj të planifikimit të veprimtarive në kuadër të SHQK-së.</li> </ul>

<b>Grupi i synuar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënës</li> <li>- Mësues, anëtarë të qeverive të nxënësve</li> </ul>
<b>Kohëzgjatja</b>	Trajnimi është programuar të zgjasë nga ora 9.00 deri në 13.00.
<b>Metodologjia</b>	<p>Trajnimi do të fokusohet kryesisht në diskutimet dhe punën me grupe. Kjo mënyrë organizimi mundëson pjesëmarrjen aktive të pjesëmarrësve dhe lejon hapësirën e nevojshme që ata të ndajnë me njëri-tjetrin ide dhe përvoja për rolin dhe veprimtaritë e tyre në kuadër të SHQK-së.</p> <p>Prezantimi i punëve të grupit do të shoqërohet nga ndërhyrje plotësuese të trajnerit/es, sipas gjykimit të tij/saj, kur të jetë e domosdoshme për të pranishmit.</p>
<b>Materialet e nevojshme</b>	Flipchart, markers, video-projektor, laptop, fletë pune

## PËRMBAJTJA E MODULIT

### SEANCA 1: Roli i organizmave të nxënësve në shkollë në kuadrin e SHQK-së

**Qëllimi:** Identifikimi i rolit dhe i funksioneve të organizmave të nxënësve në shkollë për zhvillimin e programeve që e shndërrojnë shkollën në një qendër komunitare.

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

#### Metodologjia:

- Diskutim
- Punë në grupe
- Leksion

#### Hapat:

- Trajnuesi/ja nxit diskutimin me pjesëmarrësit përmes të cilit ata sjellin kuptimin e tyre për rolin e nxënësve për zhvillimin e veprimtarive në bashkëpunim.
- Trajnuesi/ja prezanton rolet që përmbush qeveria e nxënësve për zhvillimin e veprimtarive që nxisin pjesëmarrjen e nxënësve në jetën e shkollës, në vendimmarrje dhe në bashkëpunimin me komunitetin.

#### Shënime:

Sugjerohet që trajnuesi/ja të bëjë kujdes që:

- Të marrë mendim nga të gjithë pjesëmarrësit duke nxitur pjesëmarrjen aktive e të barabartë të të gjithëve.
- Gjithashtu, është e dobishme që trajnuesi/ja t'i kushtojë vëmendje të veçantë qasjes që kanë pjesëmarrësit rreth temës për të cilën diskutohet, në mënyrë që ta përshtatë atë me nevojat dhe pritshmëritë e tyre.

#### Përmbajtja:

Shkolla qendër komunitare është një qasje që synon ta kthejë shkollën në vendin



ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi. Përfshirja e nxënësve në të gjitha aspektet e jetës në shkollë është shumë e rëndësishme. Ata duhet të mësojnë sesi të marrin vendime dhe të jenë përgjegjës për rezultatet e këtyre vendimeve.

Fëmijët dhe të rinjtë duhet të njohin dhe të mbajnë qëndrim për çështjet dhe problematikat sociale të komunitetit. Partneriteti me aktorët e tjerë krijon mundësinë e ngritjes dhe realizimit të projekteve të përbashkëta me tematika nga komuniteti, duke mundësuar gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e tyre dhe aftësuar nxënësit për të kontribuar për komunitetet e tyre.

Organizmat përfaqësues të nxënësve në shkollë luajnë rol parësor në edukimin e vlerave e qëndrimeve demokratike dhe i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe të binden se edhe ata mund të jenë aktorë të ndryshimit në shkollë, në komunitet dhe më gjerë në shoqëri.

Objekti i punës së qeverisë së nxënësve përbëhet nga veprimtari të cilat përmbushin rolin e saj. Qeveria e nxënësve mund të hartojë e të zbatojë, në marrëveshje me drejtuesit e shkollës, projekte që janë në interes të përmbushjes së objektivave të shkollës dhe të rritjes së mirëqenies së nxënësve të saj.

Në planifikimin dhe kryerjen e veprimtarive përgjatë vitit shkollor, qeveria e nxënësve bashkëpunon ngushtë me drejtuesit e shkollave, mësuesit dhe prindërit; konsultohet rregullisht me nxënësit e tjerë të shkollës dhe përfshin sa më shumë nxënës në veprimtaritë e organizuara.

Qeveria e nxënësve, megjithëse përbëhet nga një grup nxënësish, në të vërtetë është zëdhënëse e interesave të komunitetit të nxënësve për të mbrojtur të drejtat e tyre, për të kontribuar në plotësimin e nevojave dhe zhvillimin e interesave të tyre, duke synuar një shërbim arsimor sa më cilësor.

Nëpërmjet qeverisë së tyre, qeverisin të gjithë nxënësit e shkollës. Ata përfshihen në zgjidhjen e problemeve të shkollës, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, stafin dhe prindërit, në të mirë të shkollës dhe të vetë nxënësve.

Funksionimi i qeverisë së nxënësve krijon një mentalitet të ri për pozicionin dhe rolin e nxënësve në shkollë, duke i parë ata si partnerë dhe pjesëmarrës aktivë në proceset e vendimmarrjes në shkollë dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Qeveria e nxënësve bashkëvepron me organet kolegjiale të shkollës.

Qeveria e nxënësve planifikon dhe realizon një gamë të gjerë veprimtarish, ndër të cilat:

## ***Veprimtari për vlerësimin e nevojave të komunitetit të nxënësve***

Veprimtari të tilla kanë të bëjnë me përfaqësimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të nxënësve të drejtuesit e shkollës ose organet kolegjiale. Këtu përfshihen si veprimtari që kanë të bëjnë me mbledhjen e informacionit nga nxënësit (me anë të bisedave, vëzhgimeve, pyetësorëve etj.), ashtu edhe veprimtari që kanë të bëjnë me paraqitjen e informacionit të drejtuesit e shkollës ose organet kolegjiale dhe diskutimin me ta.

## ***Veprimtari që nxitin një komunikimin më të mirë brenda në shkollë***

Përmirësimi i komunikimit brenda komunitetit të shkollës është një përgjegjësi e përbashkët dhe qeveria e nxënësve mund të kontribuojë në këtë proces duke ndërtuar ura komunikimi me nxënësit e shkollës, drejtuesit e shkollës, stafin dhe prindërit. Këtu përfshihet prezantimi para mësuesve dhe këshillit të prindërve, i veprimtarive të kryera, nxjerrja e një gazete etj. Qeveria e nxënësve bashkëpunon me bordin e shkollës në ato raste kur tematika përfshihet në funksionet e bordit. Bordi i shkollës jo vetëm dëgjon përfaqësuesit e qeverisë së nxënësve, por edhe i përgjigjet konkretisht shqetësimeve të saj.

Mbështetja dhe udhëzimet e ofruara nga një mësues janë shumë të dobishme për një qeveri nxënësish, kur planifikon apo organizon veprimtaritë (p.sh., për organizimin e një veprimtarie sportive mund t'i kërkohet mendim mësuesit të edukimit fizik). Nga ana tjetër, anëtarë të qeverisë së nxënësve është e dëshirueshme të ftohen në mbledhje të personelit mësimor në rastet kur tematika përshtatet me funksionet ose me veprimtarinë aktuale të qeverisë së nxënësve.

## ***Veprimtari për të ndihmuar nxënësit e tjerë për përparimin e tyre***

Qeveria e nxënësve mund të kontribuojë duke propozuar metoda konkrete në funksion të përparimit të nxënësve si p.sh., për të ndihmuar nxënësit me vështirësi në të nxënë, për të ndihmuar integrimin e nxënësve që fillojnë për herë të parë shkollën ose një nivel shkollimi.

### ***Veprimtari që ndihmojnë mbarëvajtjen e shkollës***

Qeveria e nxënësve mund të japë ndihmesë në mënyrë aktive në mbarëvajtjen e shkollës duke formuar grupe të përkohshme pune me nxënës për një çështje të posaçme (për disiplinën, për mjedisin etj.) dhe të paraqesë te drejtuesit propozime konkrete. Qeveria e nxënësve mund të propozojë edhe veprimtari jashtëkurrikulare (p.sh., organizimin e konkurseve).

### ***Veprimtari që lidhen me ngjarje shkollore sportive dhe kulturore***

Qeveria e nxënësve mund të ndihmojë në organizimin dhe zhvillimin e sporteve dhe aktiviteteve kulturore në shkollë.

### ***Veprimtari që sigurojnë komunikimin me qeveritë e nxënësve të shkollave të tjera***

Krijimi i një rrjeti të shkollave si qendra komunitare dhe shkëmbimi i përvojave midis tyre kërkon dhe mundëson që qeveria e nxënësve të një shkolle të bashkëpunojë me qeveritë e nxënësve të shkollave të tjera (p.sh., veprimtari të përbashkëta artistike, sportive, projekte të përbashkëta). Në këtë këndvështrim një vlerë të veçantë do të kishte bashkëpunimi me një qeveri nxënësish të formuar rishtazi në favor të kësaj të fundit.

## SEANCA 2: Bashkëpunimi i nxënësve me aktorë dhe partnerë të shkollës, format e bashkëpunimit

**Qëllimi:** Demonstrimi i formave të ndryshme të bashkëpunimit midis nxënësve, organizmave të tyre përfaqësues në shkollë dhe aktorëve e partnerëve të shkollës si qendër komunitare.

**Kohëzgjatja:** 60 min

### Metodologjia:

- Diskutim
- Punë në grupe
- Leksion

### Hapat:

1. Trajnuesi/ja nxit diskutimin me pjesëmarrësit përmes të cilit ata sjellin kuptimin e tyre për rolin e nxënësve për nxitjen e bashkëpunimit me aktorët dhe partnerët e shkollës.
2. Trajnuesi/ja prezanton format e bashkëpunimit të nxënësve dhe organizmave të tyre përfaqësues në shkollë e partnerëve të shkollës.

### Shënime:

Sugjerohet që trajnuesi/ja të bëjë kujdes që:

1. Të marrë mendim nga të gjithë pjesëmarrësit duke nxitur pjesëmarrjen aktive e të barabartë të të gjithëve.
2. Gjithashtu, është e dobishme që trajnuesi/ja t'i kushtojë vëmendje të veçantë qasjes që kanë pjesëmarrësit rreth temës për të cilën diskutohet, në mënyrë që ta përshtatë atë me nevojat dhe pritshmëritë e tyre.

### Përmbajtja:

Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive mes shkollës dhe partnerëve të shkollës kërkon komunikim dhe bashkëpunim të nxënësve dhe të gjitha palëve të përfshira, si brenda në shkollë ashtu dhe jashtë saj.

## Qeveria e nxënësve dhe nxënësit

Qeveria e nxënësve është element i rëndësishëm i planifikimit dhe i vendimmarrjes në shkollë. Ajo është lidhja kryesore midis familjes, komunitetit dhe shkollës. Rolet e saj janë të qarta:

- Është partnere ose lehtësuese në punën për arritjen e objektivave të shkollës.
- Qeveria e nxënësve përcjell zërin e nxënësve në strukturat e tjera të shkollës dhe nëse është e nevojshme edhe jashtë saj, për plotësimin e interesave të komunitetit të nxënësve, për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe për një arsimim sa më cilësor.
- Inkurajon dhe lehtëson angazhimin e prindërve dhe komunitetit në procesin e planifikimit dhe zhvillimeve në shkollë.

Komunikimi ndërmjet qeverisë së nxënësve dhe nxënësve të shkollës, ndërmjet qeverisë së nxënësve dhe drejtuesve të shkollës, mësuesve e prindërve, është shumë i rëndësishëm dhe synon që i gjithë komuniteti i shkollës të kuptojë dhe të ndihmojë në realizimin e programeve dhe veprimtarive që nxënësit planifikojnë.

Nxënësit duhet të informohen rregullisht për veprimtaritë e qeverisë së nxënësve. Përfaqësues të çdo klase rregullisht duhet të informojnë dhe të dëgjojnë opinionet e idetë e nxënësve të klasës.

Atyre duhet t'u krijohet mundësia të shprehin pikëpamjet e tyre për çështjet që diskutohen në qeverinë e nxënësve dhe për të propozuar çështje për diskutim.

Një komunikim i frytshëm dypalësh realizohet konkretisht me forma e mjete të ndryshme disa prej të cilave rekomandohen në vijim:

- Afishimi i planit të veprimtarive dhe veprimtarive të zhvilluara nga nxënësit në kuadër të këtij programi. Këtij qëllimi mund t'i shërbejë përgatitja e një gazete ose reviste, si një mënyrë e dobishme informimi e cila ndërgjegjëson për arritjet, për planet në vazhdim, dhe rrit interesin dhe pozitivitetin për punën e qeverisë së nxënësve.
- Takime periodike të nxënësve përfaqësues në organizmat e shkollës me nxënës të klasave të tyre për qëllime informimi dhe marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve në lidhje me veprimtaritë e planifikuara.
- Këshillime me drejtuesit e shkollës, bordin, mësuesit e këshillin e prindërve për probleme që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e shkollës.

- Një nga mënyrat me të cilën nxënësit e shkollës komunikojnë me qeverinë e tyre është ajo informale, nëpërmjet bisedave të lira.

Kryesia e qeverisë së nxënësve duhet të planifikojë edhe mënyra të tjera formale për t'u informuar për interesat, dëshirat, problemet dhe sugjerimet e nxënësve të shkollës, si për shembull:

- të caktojë një orar në mjedisin e saj të punës për takime me nxënësit;
- të zhvillojë biseda të organizuara me nxënës të një klase edhe thjesht për të informuar për punën e kryer;
- të kryejë pyetësorë apo intervista për një temë të caktuar;
- të qarkullojë planin mujor të veprimtarive për të marrë reagime nga nxënësit;
- të vendosë diku në shkollë një kuti ku nxënësit mund të futin ide e sugjerime.

## Qeveria e nxënësve dhe drejtuesit e shkollës

Drejtuesit e shkollës, jo vetëm për funksionin e tyre si përgjegjës të ekipit koordinator të shkollës qendër komunitare, por dhe për rolet që përmbushin në këtë proces. Drejtuesit e shkollave duhet të jenë nismëtarë dhe mbështetës të pjesëmarrjes së nxënësve në veprimtari që nxisin përmirësimin e cilësisë së të nxënësve, që sigurojnë përmbushjen e interesave dhe nevojave të nxënësve si dhe mundësojnë pjesëmarrjen e komunitetit.

Roli i drejtorit të shkollës është i dyfishtë; nga njëra anë si bashkëpunues dhe udhërrëfyes i vazhdueshëm i nxënësve për planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive, dhe nga ana tjetër si monitorues i tyre.

Nga njëra anë, drejtuesi duhet të jetë i gatshëm të këshillohet me qeverinë e nxënësve, të dëgjojë, të reflektojë dhe të përfshijë qeverinë e nxënësve për çështje të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e nxënësve.

Nga ana tjetër, qeveria e nxënësve për një sërë problemesh duhet të ndjejë nevojën për këshillim me drejtuesin.

## Qeveria e nxënësve dhe bordi i shkollës

Në bordin e shkollës bëjnë pjesë një ose më shumë përfaqësues të qeverisë së nxënësve, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

Kryetari i qeverisë së nxënësve merr pjesë edhe në disa prej komisioneve të formuara nga bordi i shkollës.

Disa ndër format e bashkëpunimit mund të jenë:

- Anëtarë të Bordit të shkollës mund të ftohen herë pas here të marrin pjesë në mbledhjet e qeverisë së nxënësve.
- Kryetari i qeverisë së nxënësve ose përfaqësues të saj prezantojnë herë pas here, para bordit, punën e kryer. Për projekte të cilat ndërmerren në bazë shkolle, qeveria e nxënësve bashkëpunon me bordin.

## Qeveria e nxënësve dhe komuniteti

Qeveria e nxënësve mund të jetë një burim i rëndësishëm dhe i besueshëm informacioni rreth komunitetit duke ndërtuar së pari “Profilin e shkollës komunitare”. Ky lloj profili përfshin një përshkrim të kushteve ekonomike, shoqërore dhe shëndetësore të komunitetit të shkollës dhe përfshin identifikimin e nevojave të komunitetit që lidhen me të nxënët e nxënësve dhe mirëqënien e tyre. Qeveria e nxënësve mund të nisë krijimin e këtij profili, së pari duke identifikuar fushat e përgjithshme të cilat përfshijnë, p.sh.:

- *Kushtet ekonomike, shoqërore dhe shëndetësore të komunitetit*

Familjarizimi me kushtet ekonomike, shoqërore dhe shëndetësore të komunitetit mund të shërbejë për të kuptuar mjedisin e gjerë në të cilin nxënësit mësojnë dhe jetojnë.

- *Nevojat dhe dëshirat e anëtarëve të komunitetit*

Identifikimi i nevojave dhe dëshirave të komunitetit i shërben qeverisë së nxënësve të njohë më mirë barrierat që kushtëzojnë suksesin e nxënësve.

- *Burimet*

Identifikimi i burimeve të komunitetit ndihmon qeverinë e nxënësve për krijimin e një pamjeje të përgjithshme të mundësive që mbështesin suksesin e nxënësve dhe mirëqënien e tyre.

Për secilën nga fushat, qeveria e nxënësve mund t’i adresojë vetes pyetjet:

- Cili është informacioni që mund të na nevojitet?
- Cilët mund të jenë burim i informacionit në komunitet?
- Cila mund të jetë rruga më e mirë për të grumbulluar informacionin?

## SEANCA 3: Planifikimi i veprimtarive të nxënësve

**Qëllimi:** Aftësimi i pjesëmarrësve për planifikimin e veprimtarive dhe hartimin e planit vjetor e mujor në kuadër të SHQK-së.

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

### Metodologjia:

- Diskutim
- Punë në grupe
- Leksion

### Hapat:

- Trajnuesi/ja nxit diskutimin me pjesëmarrësit për rëndësinë e planifikimit të veprimtarive dhe përfshirjen e nxënësve në këtë proces.
- Trajnuesi/ja prezanton formatet e planeve vjetore dhe mujore dhe përmes punës në grup ndihmon pjesëmarrësit në modelimin e planeve të ndryshme.

### Shënime:

Sugjerohet që trajnuesi/ja të bëjë kujdes që:

- Të marrë mendim nga të gjithë pjesëmarrësit duke nxitur pjesëmarrjen aktive e të barabartë të të gjithëve.
- Gjithashtu, është e dobishme që trajnuesi/ja t'i kushtojë vëmendje të veçantë qasjes që kanë pjesëmarrësit rreth temës për të cilën diskutohet, në mënyrë që ta përshtatë atë me nevojat dhe pritshmëritë e tyre.

### Përmbajtja:

Planifikimi i veprimtarive të qeverisë së nxënësve është një moment delikat dhe tepër i rëndësishëm, të cilit duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur.

Një parapërgatitje e mirë i ndihmon nxënësit të skicojnë në mënyrë efektive një proces konsultimi me nxënësit e tjerë, në mënyrë që t'i përshtaten më mirë nevojave të tyre. Konsultimi i gjerë shërben për vlerësimin e nevojave dhe interesave reale të nxënësve për përcaktimin e veprimtarive, llojin e tyre, qëllimet, pjesëmarrësit, kohën



dhe burimet në dispozicion. Është e nevojshme të bëhet mirë shpërndarja e roleve dhe përgjegjësi midis anëtarëve të grupeve që do të punojnë për zhvillimin e një veprimtarie të caktuar.

Qeveria e nxënësve organizon takime (mbledhje) pune me anëtarët e saj. Mbledhjet mund të lihen në një ditë fikse të javës ose të muajit. Megjithatë zhvillohen edhe takime, tematika e të cilave nuk mund të presë derisa sa të vijë dita e caktuar. Anëtarët e qeverisë së nxënësve duhet të takohen jo më rrallë se një herë në muaj. Të gjithë pjesëmarrësit njoftohen një javë përpara për tematikën e mbledhjes në mënyrë që të kenë kohë të përgatiten për diskutim. Tematika e mbledhjes duhet të reflektojë sugjerimet e anëtarëve të qeverisë dhe të nxënësve të shkollës nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Drejtuesi i mbledhjes duhet të bëjë kujdes që të gjithëve t'u krijohet mundësia për të diskutuar.

Vendimet në mbledhje duhet të merren me konsensus. Për të marrë një vendim caktohet në parim numri i domosdoshëm i anëtarëve që duhet të jenë prezent. Mbledhjet duhet të jenë efçente dhe të mos zgjatin shumë e të bëhen të mërzitshme.

Në çdo mbledhje të qeverisë së nxënësve, sekretari mban procesverbal, ku shënohen data, qëllimi, pjesëmarrja, diskutimet dhe vendimet. Qeveria organizon edhe mbledhje të zgjeruara, p.sh., me pjesëmarrjen edhe të drejtuesve të shkollës, të këshillit të prindërve etj. Qeveria e nxënësve organizon edhe mbledhje më të ngushta për shembull takime të një grupi nga qeveria e nxënësve me drejtuesit e shkollës etj.

## **Planifikimi i veprimtarive**

Është shumë e rëndësishme që kur hartohet plani i shkollës si qendër komunitare, t'i kushtohet rëndësi e veçantë gjetjes së strategjive të përshtatshme për të tërhequr sa më shumë aktorë në komunitet për zbatimin e planit dhe realizimin e veprimtarive të parashikuara në të. Shumë nga aktorët nuk tërhiqen për të marrë pjesë në veprimtaritë e parashikuara nëse nuk janë prezent aq sa duhet në planin e hartuar dhe nëse nuk shohin mjaftueshëm atë që do të "korrin" nga kjo pjesëmarrje dhe përfshirje e tyre.

Qeveria e nxënësve harton planin e saj vjetor, ku planifikohen veprimtaritë për të gjithë vitin. Është e dobishme që për hartimin e planit vjetor të merret mendimi i sa më shumë nxënësve.

Planin vjetor duhet të jetë realist, domethënë të parashikojë veprimtari që mund të kryhen. Çdo veprimtari, që të rezultojë e suksesshme, duhet menduar e planifikuar me kujdes dhe me detaje.

Planin vjetor hartohet mbi bazën e prioriteteve të identifikuar nga secila klasë e shkollës nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Hartimi i planit vjetor duhet t'i referohet edhe

planit vjetor të shkollës për të evituar paralelizmat dhe kundërshtitë. Për këtë arsye organizohen takime konsultative me drejtorin e shkollës dhe me bordin e shkollës. Varianti përfundimtar, pas prezantimit në secilën klasë, shpallet që të bëhet i njohur për të gjithë dhe një kopje i dërgohet drejtorit të shkollës.

Përgjatë zbatimit të planit vjetor, vendimi për ndonjë ndryshim merret me shumicë votash në një mbledhje të qeverisë.

Plani vjetor detajohet në plane mujore.

Pasi mbarimit të një veprimtarie, është në dobi të punës të gjendet koha për ta vlerësuar:

- Nëse ishte e suksesshme?
- Çfarë problemesh pati?
- Çfarë duhet parasysh për herë tjetër?

Në fund të vitit vlerësohet e gjithë puna: çfarë është arritur, çfarë nuk është arritur dhe pse. Për këtë qëllim hartohet raporti përfundimtar i cili merr parasysh edhe opinionet me shkrim nga drejtori, bordi i shkollës dhe këshilli i prindërve. Të gjithë nxënësve të shkollës u jepet mundësia të lexojnë raportin përfundimtar.

Qeveria e nxënësve mund të hartojë e të zbatojë projekte dhe veprimtari të cilat:

- janë në interes të procesit mësimor;
- ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset e vendimmarrjes;
- edukojnë vlera dhe qëndrime demokratike;
- ndikojnë në ndërgjegjësimin e nxënësve për problemet sociale, brenda dhe jashtë shkollës;
- aftësojnë nxënësit për zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshet moshë e tyre;
- përmirësojnë kushtet e shkollës;
- ndikojnë në ruajtjen e mjedisit;
- ndikojnë pozitivisht në klimën e shkollës.

Qeveria e nxënësve mund të kërkojë mbështetje financiare nga subjekte të ndryshme për realizimin e veprimtarive të veta të planifikuara. Qëllimi se përse do të kërkohen dhe si do të përdoren fondet vendoset kolegjisht në mbledhje dhe u bëhet e ditur nxënësve të shkollës.

Përdorimi i fondeve kërkon zbatimin e disa rregullave të cilat janë të njëjta me rregullat financiare të shkollës.

## Shtojcë 1: Programi i trajnimit

Veprimtaria	Koha
<p><i>Hyrje</i> Prezantimi i pjesëmarrësve. Mirëseardhja e pjesëmarrësve dhe prezantimi me grupin e trajnimit. Prezantimi i objektivave të trajnimit</p>	<b>9.00 - 9.30</b>
<p><i>Seanca 1:</i> Roli i organizmave të nxënësve në shkollë në kuadrin e SHQK-së</p>	<b>9.30 – 11.00</b>
<p><i>Pushim</i></p>	<b>11.00 – 11.30</b>
<p><i>Seanca 2:</i> Bashkëpunimi i nxënësve me aktorë dhe partnerë të shkollës, format e bashkëpunimit</p>	<b>11.30 – 12.30</b>
<p><i>Seanca 3:</i> Planifikimi i veprimtarive të nxënësve</p>	<b>12.30 – 13.30</b>
<p><i>Mbyllja</i> Mbyllja e trajnimit, vlerësimi dhe detyra në vazhdim për të siguruar vazhdimësinë e trajnimit</p>	<b>13.30 – 14.00</b>

## Shtojcë 2: Format vlerësimi për trajnimin

Cilat ishin 3 gjërat më të vlefshme për të cilat mësuar në këtë trajnim?

---



---



---

Cilat ishin 2 gjërat më pak të vlefshme në këtë trajnim?

---



---

Shëno sa i kënaqur ke mbetur nga ky trajnim duke konsideruar:

(1- shkëlqyeshëm, 2- shumë mirë, 3- mirë, 4- mjaftueshëm, 5- ka nevojë për përmirësim)

stilin dhe mënyrën e konceptimit të trajnimit	1	2	3	4	5
përmbajtjen e trajnimit	1	2	3	4	5
dobinë e diskutimeve	1	2	3	4	5
përgatitjen dhe aftësitë e trajnerëve	1	2	3	4	5

Nëse do të përgatiteshin trajnime të tjera për ju dhe për prindër të tjerë, thuaj dy tema që do të ishin më me shume interes?

---



---



---



---

**Ju faleminderit!**



## **Save the Children**

Rr: "Komuna e Parisit", Lagjia 8,  
Pallatet I Maji, Vila "Lami";  
P.O. Box 8185, Tiranë - Albania  
Tel: +355 4 2261840 / 2261929 / 2266227  
Fax: +355 4 2263 428  
E-mail: [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org)  
Web Page: [albania.savethechildren.net](http://albania.savethechildren.net)  
Facebook: [savethechildrenal](https://www.facebook.com/savethechildrenal)  
Twitter: [SaveChildrenAlb](https://twitter.com/SaveChildrenAlb)